



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE - MUNICIPAL GJILAN - GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT

KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE

Në bazë të nenit 13 të Ligjit veteqeverisjes lokale dhe duke u mbështetur nenit 79 pika d) dhe 82.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, kryetari i komunës, merrë këtë :

V E N D I M

I. Emërohet komisioni për pranim teknik dhe llogarin përfundimtare të punëve të kryera të projektit :
**Furnizimi dhe montimi i nxemjes qendrore në sallën e edukatës fizike në Sh.F “
Musa Zajmi “ në Gjiçan
Nr.Prokurimit GL 651 17 063 121:**

Komisioni nga pika I. e këtij vendimi ka këtë përbërje :

1. Fazli Sermaxhaj Kryetar i Komisionit
2. Zenun Ukshini anëtar i komisionit
3. Faïd Hoxha anëtar i komisionit

II. Detyrë e komisionit është të kryej pranimin teknik të punimeve të ekzekutuara nga kompania: **N.P.SH “DONI TERM” nga Shturbullova – Drenas**, në tërësi sipas kontratës për ekzekutimin e punëve dhe të hartojë procesverbal me shkrim në të cilin do të jepë mendim dhe konstatoj se projekti – objekti në fjalë :

- ✓ I përmbushë - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit apo
- ✓ Nuk i përmbushë - kushtet për dhënjen e lejes së përdorimit

III. Gjatë pranimin teknik janë të obliguar të marrin pjesë përfaqësuesit e autorizuar të kryesit të punimeve dhe organi mbukqyrës, të cilët do të japin informatat e nevojshme lidhur me realizimin e punimeve, komisionit për pranimin teknik të projektit .

IV. Komisioni është i obliguar të përgatis raport me shkrim për punën e vet, i cili duhet t'i prezantohet zyrës së prokurimit dhe zyrës së projekteve.

V. Komisioni është i obliguar që të fillojë punën menjëher pas pranimin të këtij vendimi, ndërsa ta përfundojë në afatë prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij vendimi .

Të i dërgohet :

- arkivës
- zyrës së prokurimit
- zyrës së projekteve
- kryesit të punimeve
- antarëve të komisionit
- mbikqyrsit të punimeve

Më datë; 18.05.2018



Kryetari i Komunës

Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Bazuar në **nenin 13**. Të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr: **03/L-040, nenit 78, paragrafi 1** të Statutit të Komunës së Gjiçanit, lidhur me pagesën e subvencioneve për rastet për personat fizik për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore, mbështetur në Rregulloren komunale për subvencione Nr: **01-016-144327 datë: 30.12.2014**, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

-I-

Me këtë Vendim të bëhet pagesa e mjeteve financiare në vlerë totale prej: **2820 €**, me shkronja /**dymijëtetëqindënjëzetëeuro**/ sipas regjistrimit të rekomanduar nga komisioni e të aprovuar nga ana e kryetarit të Komunës nr: **04-553/01-0049641/18, datë: 21.05.2018**. për rastet e ndihmave për barëra dhe mjete ndimëse shëndetësore sipas Rregullores komunale për subvencione nr:**01-016-144327, datë:30.12.2014**,

-II-

Pagesa e mjeteve sipas këtij vendimi bëhet nga kodi për subvencione i DSHMS-së

-III-

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi financiar i Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

-IV-

Ky vendim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga ana e kryetarit të Komunës




Kryetari i Komunës:

Z. Lutfi Haziri /



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. **016-126211** të datës **06.11.2014**, Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

VENDIM
PËR
PAGESËN E MJETEVE FINANCIARE PËR SUBVENCIONIMIN E
INSTITUTIT PËR STUDIME LIGJORE DHE DEMOKRATIKE (ISLD)

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej **500 €** (pesëqind euro) për subvencionimin e Institutit për Studime Ligjore dhe Demokratike (ISLD), për organizimin e konferencës shkencore rajonale "Kosova, 10 vjet shtet-sfidat dhe të arriturat në arsim, siguri, ekonomi dhe sundim të ligjit".
2. Pagesa e mjeteve financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Mjetet derdhen në emër të përfituesit në xhirrollogarinë nr. **1110299651000178 Pro Credit Bank**
4. Pjesë e këtij vendimi është projekti i përfituesit.
5. Zbatimin e këtij vendimi e bënë Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet


- Palës
- DBF-së
- Arkivit.



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA-MAYOR'S OFFICE-BAŞKAN OFISI

Në pajtim me dispozitat e nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 78, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit, Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të kërkesës me nr.02-016-49048, datë 18.05.2018 të Arlinda Hasanit për shkëputje të njëanshme të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, merr:

VENDIM

1. Aprovohet kërkesa nr. 02-016-49048, datë 18.05.2018 parashtruar nga Arlinda Hasani e angazhuar në pozitën Zyrtar ligjor në Zyrën e Prokurimit dhe shkëputet Marrëveshja për Shërbime të Veçanta nr.654 e datës 22.08.2017, nga data 21.05.2018
2. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Zyra e Prokurimit dhe Njësia e personelit.
3. Vendimi hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Vendimi t'i dorëzohet
-Udheheqësit të Z.Prokurimit
-Arlinda Hasani
-DBF



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së nr. 03/L-040, nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjilanit, me ndryshimet dhe plotësimet 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjilanit merr këtë:

**V E N D I M
PËR
PAGESËN E FATURËS PËR DEBATIN E ORGANIZUAR NGA KLUBI I
GAZETARVE "BEQIR MUSLIU" NË GJILAN**


1. Me këtë vendim bëhet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 480€ (katërqindetëdhjetë euro) në emër të organizimit të debatit nga klubi i gazetarëve "Beqir Musliu" nga Gjilani
2. Pagesa bëhet mbi bazën e faturës: nr. **0199681** dt. **15.05. 2018** me nr. fiskal **600213756**.
3. Bartja e mjeteve bëhet në xhirollogarinë me **1150115323000195** në Gjilan.
4. Pjesë e këtij vendimi është fatura e cekur si në pikën 2 të këtij vendimi.
5. Pagesa e faturës do të bëhet nga kodi buxhetor mallra dhe shërbime nga Zyra e Kryetarit.
6. Zbatimin e këtij vendimi e bënë zyrtari/ja financiar/e që menaxhon me disponueshmërinë e mjeteve te Zyra e Kryetarit.
7. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të tij.

Vendimi i dorëzohet:


- Palës,
- DBF-së,
- Arkivit.



**Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



**ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - PRESIDENT'S OFFICE**

Në bazë të nenit 59 të ligjit nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Menaxheri i Prokurimit në bashkëpunim me Kryetarin e Komunës nxjerr këtë :

**V E N D I M
PËR EMRIMIN E KOMISIONIT PËR VLERSIMIN E OFERTAVE
Dezinfektimi, dezinfektimi dhe Deratizimi (DDD) ne Komunen e
Gjilanit
GI 651 18 018 211**

Anëtarët e komisionit sipas këtij vendimi janë:

1. Sabit Azizi kryetar i komisionit
2. Vehbi Haziri anëtar i komisionit
3. Ahmet Daku anëtar i komisionit

Neni 2

Autoriteti kontraktues në bashkëpunim me Departamentin e Prokurimit duhet të caktoj një komision për vlerësimin e tenderëve me funksione vetëm këshilluese për zyrtarin e prokurimit.

Neni 2.1

Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen plotësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.2

Komisioni do të funksionojë nga dita e miratimit të vendimit lidhur me themelimin e tij deri në plotësimin e të gjitha detyrave të dhëna nga autoriteti kontraktues me shkrim, ose derisa të mund të merret vendimi për ndërprerjen e procedurës së prokurimit.

Neni 2.3

Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të ftojë, vetë ose me iniciativën e komisionit, ekspertë të jashtëm atëherë kur kërkohen njohuri teknike ose të specializuara për lëndën e prokurimit dhe që përndryshe nuk gjenden brenda autoritetit kontraktues. Ekspertët e tillë duhet të pranojnë me shkrim që në mënyrë të prerë i nënshtrohen dispozitave të nenit 11 të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete afariste.

Neni 2.4

Në përfundim të detyrës së tij, Komisioni do t'i japë zyrtarit të prokurimit një rekomandim bashkë me një raport për punën e tij dhe një deklaratë me arsyet që e mbështesin atë rekomandim.

Neni 3

Komisioni për vlerësimin e ofertave do të fillojë punën menjëherë ne rastin e pranimit të këtij vendimi

Neni 4

Vendimi është i plotfuqishëm me aktin e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe Menaxherit të Prokurimit.

Jehona Hyseni

u.d. Zyrtare Përgjegjese e Prokurimit



Lutfi Haziri
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA - MAYOR'S OFFICE – BAŞKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të LVL-së; nenit 13 dhe 78.1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. 016-126211 të dt. 06.11.2014 dhe me ndryshimet dhe plotësimet 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018 , Kryetari i Komunës së Gjiçanit, merr këtë:

VENDIM

1. Me këtë vendim të gjithë nëpunësit civil të Komunës së Gjiçanit të cilët agjërojnë Ramazanin mund ta shfrytëzojnë një orë pushim duke u paraqitur në punë një orë më vonë respektivisht ora 9.00 e mëngjesit.
2. Gjatë ditëve të Premte për faljen e Xhumasë të njëjtit mund ta shfrytëzojnë një orë pushim duke filluar nga ora 13.00 deri ora 14.00
3. Me këtë Vendim të njoftohen të gjithë drejtorët e drejtorive



Kryetari i Komunës
Lutfi Haziri